

POLITIKA PËR SHËNDETIN DHE SIGURINË GJATË PUNËS

Misioni ynë është të krijojmë kushte të favorshme për konkurrencë efektive dhe të qëndrueshme në tregun e komunikimeve elektronike për t'i shërbyer interesave të përdoruesve, ekonomisë dhe industrisë së komunikimeve, nëpërmjet zbatimit efektiv, transparent, adekuat dhe proaktiv të mjeteve rregullatore.

Agjencia e Komunikimeve Elektronike është organizatë me përgjegjësi shoqërore që përpiqet të zvogëlojë rreziqet dhe dëmet në vendin e punës, të kujdeset vazhdimisht për shëndetin dhe sigurinë e punonjësve, si dhe të përmirësohet vazhdimisht përmes sistemit të zbatuar të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë në përputhje me kërkesat e standardit **ISO 45001:2018**.

Agjencia për Komunikime Elektronike, në përmbushjen e misionit të saj, është e përqendruar në zbatimin dhe respektimin e parimeve të mëposhtme:

- ✓ **Përmbushja e kërkesave** të sistemit të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë në përputhje me kërkesat e standardit **ISO 45001:2018**;
- ✓ **Vendosja, monitorimi dhe shqyrtimi** i politikave, objektivave dhe programeve të shëndetit dhe sigurisë në punë;
- ✓ **Përmbushja dhe tejkalimi** i kërkesave dhe pritjeve të punonjësve dhe palëve të interesuara;
- ✓ **Respektimi i dispozitave ligjore** në fuqi nga fusha e shëndetit dhe sigurisë në punë;
- ✓ **Edukimi i vazhdueshëm i personelit** nga fusha e shëndetit dhe sigurisë në punë;
- ✓ **Vendosja e komunikimit efikas** me të gjithë punonjësit dhe palët e interesuara me qëllim shkëmbimin e informacionit në lidhje me shëndetin dhe sigurinë në punë;
- ✓ **Identifikimi, menaxhimi dhe kontrollimi i rreziqeve, rreziqshmërisë dhe dëmeve** të konsiderueshme që kanë ndikim mbi shëndetin dhe sigurinë e punonjësve të AKE;
- ✓ **Eliminimi dhe mënjanimi** i rreziqeve me qëllim zvogëlimin e rreziqeve që ndikojnë mbi sigurinë dhe shëndetin e punonjësve;
- ✓ **Parandalimi i lëndimeve** në vendin e punës duke krijuar mjedis pune të sigurt, vende pune të sigurt dhe pajisje të sigurt për të gjithë punonjësit;
- ✓ **Përmirësimi i vazhdueshëm** i sistemit të menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë në përputhje me kërkesat e ISO 45001:2018;

Politika e shëndetit dhe sigurisë në punë është e disponueshme për publikun dhe është një detyrim për të gjithë punonjësit.

Numri ynë
Shkup

0201-46/12
27-07-2026

Drejtor
Nusret Haliti

